

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6208
E premte, 8 janar 2021
çmimi 0.40 €

Bombolat e 'kurdisura' në Kosovë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DHJETË DITË FUSHATË PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME
PARLAMENTARE TË 14 SHKURTIT

PARTITË FILLOJNË MOBILIZIMIN PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur të enjten për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Partitë politike do të kenë në dispozicion dhjetë ditë për t'i bindur qytetarët për t'i votuar. Fushata do të fillojë më 3 shkurt dhe të përfundojë më 12 shkurt. Shpallja e ditës së zgjedhjeve nga u. d. e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, është mirëpritur nga subjektet politike të cilat kanë filluar mobilizimin e strukturave politike

KONGRESI KONFIRMON FITOREN E JOE BIDENIT PRESIDENT I SHBA-SË

Kongresi amerikan ka certifikuar Joe Bidenin dhe Kamala Harris, pra presidentin dhe nënpresidenten e ardhshme të ShBA-së. Ligjvënësit

konfirmuan se Bideni fitoi 306 vota të Kolegjit Zgjedhor, krahasuar me 232 vota për ish-presidentin Donald Trump



DËRGOHEN PËR SHËRIM NË TURQI KATËR PACIENTË QË U LËNDUAN NGA SHPËRTHIMI NË FERIZAJ

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

MË 25 PRILL TEPسيا MUND TË NGELË NË TË NJËJTAT DUAR?

F. 11

Nga Bedri
ISLAMI



AKTUALE



ERDOGANI: PLANIFIKOJMË T'I RRISIM INVESTIMET NË SHQIPËRI

F. 3

PASAPORTAT MË TË FUQISHME TË BOTËS, KOSOVA NË VENDIN E 104-t

F. 3

NË 24 ORËT E FUNDIT, GJASHTË TË VDEKUR DHE 309 RASTE ME COVID NË KOSOVË

F. 7

EKONOMI

KELMENDI PARASHIKON NJË RËNIE EKONOMIKE PREJ MË SHUMË SE 8 PËR QIND

F. 8

RRETH 800 BIZNESE FAMILJARE JANË MBYLLUR NË GJILAN

F. 8

KULTURË

DOLI NGA SHTYPI LIBRI I FATON MEHMETAJT 'DEÇANI NËPËR SHEKUJ'

F. 12

SPORT

BASHKIMI FITON DERBIN NDAJ PONTES, RAHOVECI TRIUMFON NË MITROVICË

F. 12

Kongresi konfirmon fitoren e Joe Bidenit president i ShBA-së

NJU-JORK, 7 JANAR - Kongresi amerikan ka certifikuar Joe Bidenin dhe Kamala Harris, pra presidentin dhe nënpresidenten e ardhshme të ShBA-së. Ligjvënësit konfirman se Bideni fitoi 306 vota të Kolegjit Zgjedhor, krahasuar me 232 vota për ish-presidentin Donald Trump. Votat elektorale u miratuan pasi Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve refuzuan kundërshtimet e republikanëve ndaj votave në shtetet e Pensilvanisë dhe Arizonës. Certifikimi i votave të Kolegjit Elektoral nga ana e Kongresit amerikan është hapi i fundit në procesin zgjedhor, para inaugurimit të presidentit të zgjedhur Joe Biden dhe nënpresidentes së zgjedhur Kamala Harris më 20 janar. Demokratët do ta kontrollojnë Senatin, Dhomën e



Përfaqësuesve dhe Shtëpinë e Bardhë për herë të parë që nga viti 2009. Presidenti aktual Donald Trump ka thënë se do të ketë

një tranzicion të rregullt të pushtetit. "Edhe pse nuk jam plotësisht dakord me rezultatin e zgjedhjeve, megjithatë do të ketë një

tranzicion të rregullt më 20 janar", ka deklaruar Trump.

Presidenti Trump e ka kundërshtuar fitoren e demokratit Biden në zgjedhjet e 3 nëntorit 2020. Por, një sërë padish janë hedhur poshtë nga gjykatat e shteteve dhe ajo Supreme. Trump ka bërë akuza të pabazuara për mashtrime zgjedhore. Ai u tha mbështetësve të tij të bënin presion te zyrtarët e tyre të zgjedhur për t'i refuzuar rezultatet, duke i nxitur ata "të luftonin".

Seanca e Kongresit ka vazhduar pas rreth katër orësh trazira, pasi protestuesit e dhunshëm që mbështesin presidentin aktual të ShBA-së, Donald Trump, sulmuan ndërtesën e Kongresit duke hyrë brenda.

Policia e Uashingtonit ka njoftuar se katër njerëz kanë

vdekur gjatë sulmit në ndërtesën e Kongresit. Përveç një gruaje të qëlluar nga policia, tre të tjerë vdiqën si rezultat i "urgjencave mjekësore". Më shumë se 52 persona janë arrestuar, 47 prej tyre për shkelje të rregullave të izolimit.

Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama, ka thënë se historia do ta mbajë në mend sulmin në Kongres si një "një moment të çnderimit dhe turp të madh për kombin tonë".

Obama ka pohuar se sulmi është nxitur nga "një president i cili vazhdon të gënjejë për rezultatit e zgjedhjeve të ligjshme". Ndaj sulmit që iu bë Kongresit, ka reaguar edhe ish-presidenti tjetër i ShBA-së, George W. Bush. "Janë pamje të sëmurë dhe pikëluese", ka thënë Bush.

Nga Covidi vdiqën mbi 600 punonjës të medieve

GJENEVE, 7 JANAR - Fushata e Emblemës së Shtypit ka kërkuar që punonjësit e medieve të kenë përparësi në vaksinat anti-Covid, duke thënë se mbi 600 prej tyre tashmë kanë vdekur nga sëmundja.

Organizata joqeveritare me seli në Gjenevë, e cila ndjek vdekjet e gazetarëve në të gjithë botën, ka njoftuar se 602 punonjës të medieve kanë vdekur nga Covid-19 në periudhën mars-dhjetor të vitit të kaluar. Megjithatë, kjo

organizatë ka potencuar se nuk është e mundur të bëhet dallimi midis atyre që janë infektuar në punë dhe jashtë saj.

Lista përfshin gjithashtu gazetarët në pension. Fushata e Emblemës së Shtypit ka njoftuar se gazetarët "duhet të kenë përparësi në imunizim, sipas kërkesës" sepse, sipas saj, ata janë "veçanërisht të ekspozuar ndaj virusit" derisa raportojnë në terren.

Sipas organizatës, më shumë

se gjysma e vdekjeve janë regjistruar në Amerikën Latine: gjithsej 303 viktima.

Një total prej 145 viktimitash janë regjistruar në Azi, 94 në Evropë, 32 në Amerikën e Veriut dhe 28 në Afrikë, ka njoftuar Fushata e Emblemës së Shtypit.

Organizata tha se të dhënat e saj bazohen në informacionet që kanë ofruar mediat lokale, shoqatat kombëtare të gazetarëve dhe korrespondentët rajonalë të Fushatës së Emblemës së Shtypit.



OBSH-ja: Situata me variantin e ri të virusit është alarmante



GJENEVE, 7 JANAR - Dega për Evropë e Organizatës Botërore e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten se duhet të bëhet më shumë, pas situatës "alarmante", për shkak të përhapjes së variantit të ri, të zbuluar së fundmi të koronavirusit.

Duke folur në një konferencë për media,

drejtori për Evropë i OBSH-së, Hans Kluge, ka pohuar se situata aktuale është "pikë kthese e pandemisë", teksa Evropa po përballet edhe me rritjen e rasteve të reja, por edhe me rastet me variantin e ri të Covid-19. "Kjo është situatë alarmante, që do të thotë se për një periudhë të shkurtër

kohore ne duhet të bëjmë më shumë dhe duhet t'i shtojmë masat shëndetësore publike dhe ato sociale, që të sigurohemi që ta rrafshojmë kurbën në disa shtete", ka deklaruar Kluge, duke iu referuar variantit të ri të virusit, që fillimisht u identifikua nga Mbretëria e Bashkuar.

Britanikët e moshuar refuzojnë vaksinën e "Pfizer"-it

LONDËR, 7 JANAR - Britanikët e moshuar po refuzojnë ta marrin vaksinën e "Pfizer"-it kundër Covid-19 sepse "preferojnë të presin atë

angleze". Mjeku Paul Williams, i cili administron shpërndarjen e vaksinave te banorët, tha se të moshuarit mbi 80-vjeç këmbëngulin të presin vaksinën

e Oksfordit. Ndërkohë, 10 oficerë policie morën dozat e parashikuara për të moshuarit, pasi ata nuk u shfaqën për të marrë injeksionin, për ta

parandaluar humbjen e furnizimeve. Pasi nxirren nga kontejnerët me temperaturë -78c, doza e "Pfizer"-it duhet të përdoret brenda dy ditësh.



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, viziton Turqinë

Erdogani: Planifikojmë t'i rrisim investimet në Shqipëri

Presidentit i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, në pritjen që i bëri kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, ka konfirmuar se shteti i tij do t'i rrisë investimet në Shqipëri. Gjithashtu, Erdogan bëri me dije se brenda tre muajve do ta ndërtojë spitalin e ri në Fier

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

ANKARA, 7 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Turqi, me ftesë të presidentit Rexhep Tajip Erdogan. Kryeministri Rama dhe delegacioni shqiptar u pritën me ceremoni zyrtare në Kompleksin Presidential nga presidenti turk. Gjatë kësaj vizite u nënshkruan një sërë marrëveshesh me rëndësi për ngritjen në një stad të ri të partneritetit strategjik të bashkëpunimit mes dy vendeve.

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka bërë me dije se me Ramën kanë diskutuar për marrëdhëniet mes dy

vendeve në mënyrë gjithëpërfshirëse. "Me rastin e kësaj vizite, kemi nënshkruar deklaratën e përbashkët politike për krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Strategjik të nivelit të lartë. Kështu, ne i ngritëm marrëdhëniet tona në nivel të partnerit strategjik. Ky hap që hodhëm sot do ta mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë në çdo fushë", ka thënë Erdogan.

Ai ka shtuar se, përveç diskutimit të çështjeve bilaterale, kanë diskutuar edhe për çështje të tjera rajonale në shumë fusha kulturore dhe ekonomike. "Pra, shkëmbyem ide se çfarë mund të bëjmë në një projektet e ardhshme. Turqia është partnerja tregtare e katërt

më e madhe e Shqipërisë. Duke marrë parasysh edhe shërbimet kontraktuese, ne jemi investitori më i madh i huaj në Shqipëri, me një investim total

prej 3.5 miliardë dollarësh. Më shumë se 600 kompani turke që operojnë në Shqipëri sigurojnë punësim për më shumë se 15 mijë vëllezër shqiptarë. Në periudhën e ardhshme ne planifikojmë t'i rrisim investimet tona në Shqipëri, veçanërisht në fushat e infrastrukturës dhe turizmit. Kështu, ne parashikojmë që bashkëpunimit tonë në ekonomi t'i japim një dimension tjetër", është shprehur presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka falënderuar presidentin turk për mikpritje. "Edhe pse nuk është hera e parë që unë e vizitoj Turqinë mike, në këtë mikpritje ne të gjithë së bashku si delegacion nga Shqipëria mund të konstatojmë shprehjen e një vullneti të fortë, për të hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet mes dy vendeve, mes dy shteteve dhe dy

qeverive", ka thënë Rama.

Nga ky takim Rama mori premtimin e presidentit turk për ndërtimin e spitalit rajonal në Fier brenda tre muajsh. "Ashtu sikundër jam i lumtur që së shpejti edhe spitali rajonal i Fierit do të bëhet realitet. Tani bastet në Turqi dhe në Shqipëri janë të ndaluara me ligj. Nuk mund të vinim bast me presidentin, por basti i presidentit që spitali rajonal i Fierit të jetë gati për tre muaj është një bast shumë i fortë. Unë do ta kisha humbur me qejf këtë bast, por edhe shans për ta fituar do të kisha, duke pasur parasysh se edhe turqit, edhe shqiptarët, kur vjen puna te zbatimi poshtë, duan t'i shtysh vazhdimisht", është shprehur Rama.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në ditën e dytë të vizitës në Turqi ka vizituar Muzeun Atatürk, ku është pritur me ceremoni shtetërore dhe industrinë ushtarake turke.



Pasaportat më të fuqishme të botës, Kosova në vendin e 104-t

PRISHTINË, 7 JANAR - Qytetarët aziatikë vazhdojnë t'i mbajnë pasaportat më të fuqishme në botë sipas indeksit Henley. Për të katërtin vit radhazi, kreun e renditjes e mban Japonia me 191 destinacione, ku mund t'i udhëtojnë shtetasit e saj. Singapori është sërish i dyti me 190 vende, Koreja e Jugut dhe Gjermania ndajnë pozicionin e tretë me 189 pozicione e nuk janë shumë larg tyre as Italia,

Finlanda, Spanja dhe Luksemburgu.

Evropa është, gjithashtu, shtëpi e disa prej pasaportave më të forta të globit, duke nisur me ato të Danimarkës e Austrisë që renditen në dhjetëshen më të mirë. Pas kësaj vijne Suedia, Franca, Portugalia, Holanda e Irlanda me nga 186 destinacione. Shumë pranë tyre janë dhe Shtetet e Bashkuara, Britania e Zvicra me 185. Për krijimin e

listës, Indeksi i Pasaportave Henley përdor të dhëna nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror me renditjen e përcaktuar nga numri i vendeve ku një mbajtës i pasaportës së një kombi mund të udhëtojë pa pasur nevojë për vizë. Shqipëria renditet në vendin e 52-t. Me pasaportën shqiptare mund të udhëtohet pa vizë në 114 shtete, ndërsa Kosova është më poshtë, në vendin e 104-t.





DHJETË DITË FUSHATË PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 14 SHKURTIT

PARTITË FILLOJNË MOBILIZIMIN PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur të enjten për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Partitë politike do të kenë në dispozicion dhjetë ditë për t'i bindur qytetarët për t'i votuar. Fushata do të fillojë më 3 shkurt dhe të përfundojë më 12 shkurt. Shpallja e ditës së zgjedhjeve nga u. d. E presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, është mirëpritur nga subjektet politike të cilat kanë filluar mobilizimin e strukturave politike

organizimin e këtyre zgjedhjeve. Shpresojmë që pas këtyre zgjedhjeve do të kemi reforma zgjedhore dhe do të adresohen të gjitha çështjet. Ky është plani operacional dhe këto afate do të jenë të qasshme në faqen e KQZ-së, porsa të aprovohen në këtë mbledhje. 5 milionë e 560 mijë euro do të jetë projeksionbuxheti, por nuk do të thotë që i gjithi do të harxhohet. Prej nesër do t'ia bëjmë kërkesën qeverisë për alokimin e këtyre mjeteve", ka thënë në mbledhje kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka. Një ditë më parë, ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka shpallur zgjedhjet e reja parlamentare, të cilat do të mbahen më 14 shkurt. Caktimi i datës së zgjedhjeve të parakohshme është mirëpritur nga subjektet politike. Udhëheqësit e partive politike janë shprehur të bindur në rezultate pozitive në këto

zgjedhje. Me dekretin për shpalljen e zgjedhjeve të reja, Osmani ka shpërndarë legjislaturën e shtatë të Kuvendit të Kosovës dhe ka udhëzuar KQZ-në për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për organizimin e këtyre zgjedhjeve. "Me këtë vendim KQZ-ja është udhëzuar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës. U. d. presidentja, po ashtu, ka nxjerrë dekret për shpërndarjen e legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës", është thënë në njoftimin e Presidencës. Shpallja e ditës së zgjedhjeve është mirëpritur nga faktori politik vendor dhe ndërkombëtar. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka deklaruar se zgjedhjet e 14 shkurtit do të jenë referendum për vendin. Në profilin e vet në

"Facebook", ai ka shkruar se më 14 shkurt politika e keqe do të ndodhet para gjyqit popullor. "Pas shtatë muajve na u dëshmuua ajo që dihej nga fillimi. Zgjedhja e qeverisë koti ka qenë kot. Zgjedhje e paligjshme, jokushtetuese. Kemi humbur shumë vite, jo vetëm muaj. Këto zgjedhje nuk janë të parakohshme, por të vonuara. Mirëpo, këto zgjedhje janë referendum. Më 14 shkurt politika e keqe ndodhet para gjyqit popullor", ka shkruar Kurti, duke shtuar se më 14 shkurt, festën e zezës do ta bëjnë edhe kremte të demokracisë. "Punë e arsim, drejtësi e shëndetësi. Kaq duan qytetarët. Qeveria jonë e re do të jetë shërbim i mirë. Sepse qytetari është mbreti i republikës. Më 14 shkurt, festën e zezës e bëjmë edhe kremte të demokracisë", ka shkruar Kurti. Ndaj shpalljes së zgjedhjeve ka

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 JANAR - Fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit do të jetë dhjetë ditë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në mbledhjen e së enjtes, ka vendosur që fushata për zgjedhjet e reja të nisë më 3 shkurt dhe të përfundojë më 12 shkurt.

Në këtë mbledhje të KQZ-së është vendosur që aplikimi i subjekteve dhe kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e parakohshme do të fillojë më 8 janar dhe do të përfundojë më 16 janar. Ndërsa tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotime do të mbahet më 1 shkurt. "Jemi të obliguar nga dita e sotme t'i fillojmë përgatitjet për

reaguar edhe BE-ja, duke thënë se presin zgjedhje transparente dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Ana Pisonero, në një postim në llogarinë e vet në "Twitter", ka shkruar Pisonero. "Ne kemi marrë njoftimin për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 14 shkurt. Bashkimi Evropian pret zgjedhje të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente, të zhvilluara në përputhje me standardet ndërkombëtare në mënyrë që Kosova të mund të ecë përpara", ka shkruar ajo.

Më tutje, Pisonero ka thënë se Bashkimi Evropian do të vazhdojë të angazhohet me të gjithë në Kosovë për ta promovuar agjendën e integritetit evropian dhe reformat e nevojshme.

Shpallja e datës së zgjedhjeve

pason publikimin e aktgjykimit të plotë të Gjykatës Kushtetuese, që konstatoi se zgjedhja e Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Avdullah Hoti ishte bërë në mënyrë jokushtetuese kjo për shkak se për qeverinë Hoti kishte votuar Etem Arifi, ndaj të cilit kishte një dënim të formës së prerë, për veprën penale "mashttrim me subvencione" me dënim prej më shumë se një viti.

Në aktgjykim është thënë se qeveria Hoti nuk kishte marrë votat e nevojshme në parlament (61 vota) pasi vota e Arifit ishte e pavlefshme. Gjithashtu, aty është thënë se një person i dënuar për veprën penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tre vjetët e fundit, nuk mund të jetë kandidat për deputet e as të ketë mandat të vlefshëm në Kuvendin e Kosovës.

Osmani, pas vendimit të

Kushtetueses, e cila më 21 dhjetor konstatoi se qeveria Hoti u zgjodh në mënyrë jokushtetuese, zhvilloi konsulta me partitë politike, për ta caktuar datën e zgjedhjeve. Sipas verdiktit të Kushtetueses, u. d. e presidentit u udhëzua që të shpallen zgjedhjet e reja jo më vonë se 40 ditë pas shpalljes së aktgjykimit. Qeveria Hoti ishte zgjedhur më 3 qershor, me 61 vota të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Partitë prezantojnë aderimet dhe mobilizojnë strukturat

Prej se Gjykata Kushtetuese, në muajin e kaluar, ka bërë me dije se qeveria Hoti është e kundërligjshme, subjektet politike kanë filluar të përgatiten për zgjedhjet e parakohshme. Liderët e subjekteve politike

kanë filluar takimet me strukturat e tyre nëpër gjithë vendin dhe kanë prezantuar para publikut aderimet e reja. Në prurje të reja, këto ditë më aktive ka qenë PDK-ja, e cila ka prezantuar dy përforcime. Fillimisht, kryetari në detyrë i kësaj partie dhe kandidati për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka prezantuar analistin Faton Abdullahu dhe më pas profesorin universitar Ardian Kastrati.

Ditë më parë edhe lideri i LV-së, Albin Kurti, si ardhje të re në këtë parti ka prezantuar profesorin Mustafë Bajrami dhe disa asamblistë të LDK-së. Edhe AAK-ja dhe Nisma gjatë kësaj kohe kanë treguar se radhëve të tyre u janë bashkuar asamblistë të partive të tjera dhe disa intelektual të rinj. Subjektet politike kanë filluar të prezantojnë para mediave edhe pjesë të programeve të tyre

elektorale. PDK-ja ka bërë me dije se në programin e saj do të ketë një pako për diasporën e cila do të përfshijë edhe tre kandidatë të diasporës në listën e kësaj partie për deputetë, ndërsa pako për Luginën e Preshevës do t'i përfshijë në listën për deputetë dy përfaqësues nga Lugina e Preshevës që e përfaqësojnë secilën komunë të Luginës.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Aleanca shumë shpejt do ta publikojë programin ekonomik 2021-2025, në kuadër të të cilit do të prezantohet projekti për Fondin e Mbijetesës Ekonomike, me vlerë mbi 1 miliard euro për vitin 2021. Sipas tij, fondi do ta garantojë përkrahjen për bizneset, kthimin e punëtorëve që kanë humbur vendet e punës për shkak të gjendjes pandemike, mbështetjen për familjet në krizë ekonomike e shumë përfitime të tjera.

KËSHILLI I PRINDËRVE REAGON NDAJ KËRKESËS SË SBASHK-ut PËR SHITESAT PREJ 100 EUROSH



PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Kryesia e Këshillit të Prindërve të Prishtinës ka reaguar ndaj deklaratave të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës dhe Kulturës, të cilët kanë thënë se mund të shtyhet fillimi i gjysmëvjetorit të

dytë nëse nuk u bëhet pagesa shtesë prej 100 eurosh. "Kryesia e Këshillit të Prindërve të Prishtinës e ka analizuar deklaratën e fundit të Sindikatës së Arsimit (SBASHK), me të cilën kërcënojnë me mosfillimin e

mësimin nëse nuk bëhet pagesë shtesë (prej 100 eurosh në muaj) për mësimdhënësit sikurse për stafin e shëndetësisë dhe policisë. Kërkojmë nga SBASHK-u që të reflektohet dhe të përmbahen nga këto deklaratime

në kohë pandemie, por edhe kohë elektorale politike, që nëse kanë vullnet dhe ia duan të mirën edhe mësimdhënësve dhe fëmijëve, t'i bashkërendojnë veprimet e tyre me të gjitha palët e interesit dhe jo njëanshëm të

caktojnë afate, të hapin e mbyllin vetë vitin shkollor, që tingëllon dukshëm shantazhues, jolegjitim e as institucional", është thënë në reagimin e Kryesisë së Këshillit të Prindërve të Prishtinës.

Bombolat e 'kurdisura' në Kosovë

PRISHTINË, 7 JANAR - Një numër i madh i bombolave të gazit që përdoren nga amvisëritë, gastronomia si dhe një pjesë e industrisë nuk kalojnë nëpër faza testuese, prandaj shpesh janë shkaktuar edhe incidente në Kosovë.

Si pasojë e shpërthimit të një bombole gazi të martën në qytetin e Ferizajt u lënduan 42 persona, disa prej tyre rëndë. Pesë po trajtohen në repartin intensiv në QKUK. Duke iu referuar këtij incidenti, "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të ditur nëse kryhen inspektime të operatorëve ekonomikë që bëjnë shitjen e gazit si dhe bombolave. Nga MTI-ja është kërkuar përgjigje nëse bëhet ndonjë inspektim i cilësisë, sasisë apo sigurisë së gazit që shitet në Kosovë.

Por, në këtë institucion nuk kanë dhënë përgjigje për asnjërën nga pyetjet përveçse është rekomanduar që të kërkohej përgjigje nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. "Çështja e bombolave të gazit (pajisjeve nën presion) rregullohet me Ligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion dhe mbikëqyret

nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit", thuhet në përgjigjen e vetme që ka kthyer Naim Hajra nga Inspektorati i Tregut në këtë ministri.

Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit thonë se importuesit janë përgjegjës për vënien në treg të bombolave, të cilat, sipas kësaj ministrie, duhet t'i plotësojnë kushtet themelore të sigurisë. "Importuesi apo përfaqësuesi i autorizuar janë përgjegjës për vënien në treg të pajisjeve nën presion të cilat duhet t'i plotësojnë kushtet themelore të sigurisë. Importuesi apo përfaqësuesi i autorizuar është i obliguar që ta prezantojë certifikatën e konformitetit dhe dokumentacionin përcjellës të pajisjes nën presion", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Por, shitjen e bombolave të gazit apo pajisjeve nën presion mund ta bëjë gjithsecili operator ekonomik. Për ta bërë këtë nuk nevojitet ndonjë licencë specifike. "Sa iu përket operatorëve ekonomikë për shitjen e bombolave të gazit apo pajisjeve nën presion, nuk ka nevojë [për] licencë paraprake", thuhet në

përgjigjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Ligji parasheh kontrolle të rrepta

Ligji për pajisjet nën presion obligon çdo operator ekonomik që përdor bombola gazi që të mirëmbajë ato dhe ta trajtojë stafin duke ofruar udhëzime të nevojshme për përdorimin e tyre. Ligji parasheh edhe kontrollet e vazhdueshme teknike të bombolave të gazit. Pas shpeshimit të rasteve të shpërthimit të bombolave të gazit në Kosovë, "Radio Evropa e Lirë" ka pyetur edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamentin për Siguri Publike, për faktin nëse kryen ndonjë inspektim. Mirëpo, në Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë thënë se ky departamenti nuk e mbulon këtë fushë.

Pa test sigurie

Lirik Veselaj, njohës i sigurisë dhe shëndetit në punë, thotë se në Kosovë nuk ka kontrolle shtetërore për kualitetin dhe

gjendjen në të cilën mbahen bombolat e gazit. "Secila bombol e gazit do të duhej të kishte 'A test', një dokument i cili e dëshmon performancën e saj dhe mënyrën e përdorimit. Secila bobol e gazit do të duhej ta kishte edhe një cilin punëtorët do të njiheshin me funksionet e saj", thotë Veselaj. Ditë më parë ndodhi edhe një shpërthim i një bombole gazi në rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj ku u lënduan 12 persona. Po ashtu, 11 persona u lënduan nga shpërthimi i bombolës së gazit në vitin 2019 në Rahovec.

Prejardhja e dyshimtë e bombolave

Pjesa më e madhe e këtyre incidenteve, sipas Lirik Veselajt nga HSK - Siguria dhe Shëndeti në Punë, ndodhin për shkak të pajisjeve të pasigurta, mungesës së trajnimit të stafit si dhe ruajtjes së bombolave në vende joadekuate. "Tek operatorët ekonomikë ekziston njëfarë standardi që nuk aplikohet në Kosovë për shkak se çdo operator ekonomik që

furnizon restorantet dhe lokalet e tjera të natyrave të ndryshme me bombola gazi duhet që paraprakisht të caktojë një vend adekuat për t'i vendosur këto bombola si dhe të vendosë sinjalistikën paralajmëruese", thotë Veselaj.

Ku përdoret gazi

Kosova nuk ka treg e as infrastrukturë të gazit. Kosova parasheh që të lidhet me disa projekte të mundshme, përfshirë këtu edhe Gazsjellësin Trans-Adriatik përmes Shqipërisë thuhet në një raport të Institutit për Ekonomi të Energjisë dhe Analizë Financiare i publikuar në muajin tetor të vitit 2020. Në mungesë të infrastrukturës së gazit dhe lidhjes me gazsjellës, qytetarët e Kosovës pajisen me gaz përmes bombolave kryesisht nga kompanitë e karburanteve. Në këto pika zakonisht mund të blihen bombola të ndryshme që përdoren për ngrohje si dhe për përgatitjen e ushqimeve. Më së shumti bombolat e gazit përdoren në sektorin e gastronomisë.



Gashi thotë se gjatë fushatës zgjedhore do të zbulohet pse ra qeveria Kurti

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Ish-shëfi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka komentuar vendimin e Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që fushata zgjedhore të zgjasë dhjetë ditë. Gashi ka thënë se gjatë fushatës zgjedhore do të dalin në shesh shumë gjëra. "Shumë

gjana kanë me dalë në shesh gjatë kësaj fushate; mbi të gjitha e vërteta se pse dhe si ra qeveria (Kurti), qeveri që rrezikoi ekzistencën e Kosovës duke e futur në

konflikt me administratën më atipike të ShBA-ve! Së shpejti, heshtja merr fund", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".



Në 24 orët e fundit, gjashtë të vdekur dhe 309 raste me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar se kanë ndërruar jetë edhe gjashtë pacientë të cilët ishin të infektuar me Covid-19, ndërkaq në 24-orëshin e fundit janë regjistruar edhe 309 raste të reja me Covid. Në raportin ditor të IKShPK-së bëhet me dije se edhe 601 pacientë janë shëruar nga ky virus



komunat: Prishtinë 126 raste, Ferizaj 25 raste, Podujevë 19 raste, Vushtrri 19 raste, Mitrovicë 14 raste, Gjakovë 12 raste, Viti 11 raste, Malishevë 10 raste, Deçan

9 raste, Gjilan 7 raste, Pejë 7 raste, Prizren 7 raste, Fushë-Kosovë 5 raste, Istog 5 raste, Kaçanik 4 raste, Klinë 4 raste, Lipjan 4 raste, Suharekë 4 raste,

Drenas 3 raste, Junik 3 raste, Obiliq 3 raste, Kamenicë 2 raste, Rahovec 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë dhe Skenderaj.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 417 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 309 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të vdekjes si pasojë

e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Istog dy raste (80, 66 vjeç), Ferizaj një rast (88 vjeç), Kamenicë një rast (58 vjeç), Prishtinë një rast (84 vjeç), Prizren një rast (86 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 52 943 raste nga 192 296 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 363 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 601 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 44 436 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 144.

Rastet pozitive janë nga

Dërgohen për shërim në Turqi katër pacientë që u lënduan nga shpërthimi në Ferizaj

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 JANAR - Katër pacientë që janë lënduar nga shpërthimi i bombolës së gazit në Ferizaj janë nisur të enjten për trajtim në Republikën e Turqisë. "Katër pacientë, që janë vlerësuar nga profesionistët shëndetësorë, që janë në gjendje më të rëndë, në bazë të sipërfaqes dhe shkallës së djegies, janë dërguar në qendër të specializuar për trajtim në Turqi", ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik

Universitar i Kosovës (ShSKUK). Në këtë njoftim theksohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës kanë vepruar konform konsultave me mjekët profesionistë të fushës dhe nuk e kanë hequr askënd nga lista për trajtim jashtë vendit.

Pacientët e tjerë të lënduar nga shpërthimi i gazit po marrin trajtim nga institucionet tona shëndetësore. Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda ka njoftuar se ka filluar

hetimet me rastin e shpërthimit të bombolës së gazit që ka ndodhur në restorantin "Steak House" në Ferizaj. Si pasojë e shpërthimit të saj kanë mbetur të lënduar 44 persona.

Kërkohet shkaktari për shpërthimin e bombolës së gazit në Ferizaj

Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se

janë shumë shqetësuese lajmet për incidentet e fundit, të shpërthimeve të bombolave të gazit, njëra brenda një qendre tregtare dhe një tjetër në një lokal gastronomie, të ndodhura në Kosovë brenda një jave, ku pati shumë të lënduar. "Duhet hetim i hollësishëm i rasteve, në mënyrë që të dihet saktësisht shkaktari. A ka të bëjë me cilësinë e bombolave të gazit, si kanë hyrë në treg në Kosovë, përmes rrugëve ligjore apo janë futur në mënyrë ilegale, si dhe a i kanë pasur të kryera atestet dhe kontrollet periodike. Apo

kemi të bëjmë me instalimin dhe përdorimin jo të drejtë të tyre. Duhet ditur shkaktari dhe përgjegjësit e mundshëm të këtij incidenti. Fatmirësisht, nuk pati asnjë viktimë nga këto shpërthime, por pati shumë të lënduar dhe dëme të mëdha materiale. Institucionet përgjegjëse duhet ta ngrehin alarmin duke ndërmarrë masat e nevojshme të sigurisë, në mënyrë që të parandalohet ndonjë tragjedi edhe më e madhe nga përdorimi i bombolave të gazit", ka thënë Ahmeti.

Kelmendi parashikon një rënie ekonomike prej më shumë se 8 për qind



PRISHTINË, 7 JANAR - Biznesmeni i njohur Ramiz Kelmendi parashikon një rënie të ndjeshme ekonomike. Ai thotë se tkurrja do të jetë më shumë se 8 për qind. Ish-deputeti Kelmendi ka thënë se viti 2020 nuk ishte vit i suksesit, por vit i mbijetesës si pasojë e virusit Covid-19. Ai ka fajësuar institucionet e shtetit që nuk kanë vepruar për t'i sanuar dëmet e pandemisë. "Rënia ekonomike do të jetë shumë

më e madhe sesa që është paralajmëruar. Rënia ekonomike në shtetin e Kosovës korrespondon me rënien ekonomike të shumë veprimtarive për të cilën sigurisht që do të atakohet. Mbështetja institucionale ka munguar dhe gjithmonë është edhe e vonshme. Në këtë rast edhe Kuvendi është dashur të mblihet për të parë se sa është efekti ekonomik i pandemisë dhe cilat duhet të ishin

veprimet institucionale. Kështu që të paraprihet, e jo pastaj të ndodhë e të sanohet. Sanimi është masë e vonshme. Paraprija është masë e hershme dhe e domosdoshme", ka thënë ai. Pronari i kompanisë "Elkos Group", Ramiz Kelmendi, ka thënë në një intervistë për "KosovaPress" se pandemia Covid-19 ka pasur efekt negativ edhe në kompaninë e tij. "Sfidat janë të shumëfishta për

arsye se edhe 'Grupi Elkos' ka veprimtari të ndryshme, të shumëllojshme, që në disa ka pasur efekt më të madh pandemia, në disa ka pasur efekt më të vogël, ndërsa në disa nuk ka pasur për aq sa është pritur. Por, si mesatare del që ka pasur efekt. Sa herë që ka sfida të tilla, ne vijmë përpara problemeve të ndryshme, për arsye se kemi një numër të madh të të punësuarve në të gjithë këta lëmenj. Qëllimi ynë

është gjithë duke shpresuar se kjo pandemi të kryhet sa më shpejt, njëkohësisht edhe institucionet shtetërore të fillojnë dhe të veprojnë që të sanojnë sadopak këtë ndikim në mënyrë që mos të pësojnë të punësuarit me vende pune dhe me të ardhura personale", ka theksuar Kelmendi. Ai ka pohuar se investimet e parapara për vitin që lamë pas ishin të cunguara për shkak të pandemisë.

Bitcoin, shumë afër 40 mijë dollarëve, vlera e tregut tejkalon 1 trilion dollarë

Prishtinë, 7 janar - Bitcoin që nga fillimi i vitit 2021 ka nisur me rekorde të reja, ku për herë të parë ka tejkaluar vlerën prej më shumë se 30 mijë dollarësh. Sipas CoinMarketCap, vlera aktuale e kësaj kriptovalute është 38,508.10 dollarë, ku sipas kësaj rritje është afër kapjes së vlerës prej 40 mijë dollarësh. Nga të dhënat, brenda 24-orëve vlera e tij është rritur me mbi 10 për qind, kurse brenda një jave është mbi 35 për qind.



Kjo kriptovalutë është katërfishuar në vlerë gjatë pandemisë Covid-19. Vlera e Bitcoinit u ngrit 300 për qind në vitin 2020 dhe vetëm në muajin e kaluar ajo u rrit 50 për qind. Thyerja e rekordeve të kësaj kriptovalute po drejtohet pjesërisht nga hyrja e investitorëve më të mëdhenj në treg. Aktualisht vlera e tregut e kësaj valute ka tejkaluar 1 trilion, ku përbën rreth 70 për qind të tregut të këtyre valutave.

Rreth 800 biznese familjare janë mbyllur në Gjilan


GJILAN, 7 JANAR - Rreth 800 biznese, që kryesisht ishin familjare, janë mbyllur gjatë vitit 2020 në Komunën e Gjilanit si pasojë e pandemisë Covid-19. Megjithatë kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ka thënë se kanë arritur ta menaxhojnë mirë situatën. I

pari i Gjilanit thotë se gjatë vitit që lamë pas kanë arritur t'i realizojnë të gjitha projektet e parapara për vitin 2020. E këtë vit synon ta kthejnë Gjilanin në qytet të biçikletave. Haziri në një intervistë për "KosovaPress" tregon se nuk synon një mandat tjetër në krye të

Gjilanit, ndërsa shton se ka përbushur të gjitha projektet e synuara për komunën e ato pak që kanë mbetur thotë se do të përfundojnë këtë vit. Komuna e Gjilanit gjatë vitit të kaluar ka punuar mbi baza ditore në parandalimin e pandemisë. Haziri thotë se

janë shquar për menaxhim të mirë, duke ruajtur shëndetin e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre. Sipas vlerësimeve të Komunës së Gjilanit, del se nga pandemia është prekur më së shumti ekonomia e vogël. Pavarësisht prej problemeve me pandeminë, i pari i Gjilanit thotë se edhe

vitin që lamë pas nuk kanë munguar investimet infrastrukturale dhe ato publike, ndërsa shton se një vonesë gjashtëmuajore i ka prekur projektet afatmesme. Siç thotë ai, investimet në zonën e parë të qytetit janë ato në të cilat do të punohet edhe këtë vit në to.



Lushnja dhe Fieri prodhojnë mbi 30 për qind të perimeve në Shqipëri

LUSHNJË, 7 JANAR - Shqipëria e rriti prodhimin e perimeve me 8 për qind në vitin 2019, duke e çuar totalin në 1.2 milion ton, 34 për qind e të cilave prodhohen në Fier dhe në Lushnjë. Siç raporton Instat, Divjaka është bashkia me prodhimin më të lartë të perimeve në rang vendi me 14.4 për qind të totalit. Në vitin 2019 prodhimi i perimeve në këtë bashki shënoi rritjen më të madhe në vend apo 38 për qind. Bashkia e Lushnjës është prodhuesi i dytë më i madh i perimeve me 13.9 për qind të totalit me një rritje me 7.5 për qind në raport me vitin 2018. Prodhuesi i tretë më i madh i perimeve në vend është Ura Vajgurore me 82 mijë ton perime me 2019 me një rritje 3.1 për qind në raport me vitin e mëparshëm. Më tej prodhuesit



më të mëdhenj të perimeve në vend janë Durrësi me 57 mijë tonë, Tirana me 48 mijë tonë dhe Rogozhina me 40 mijë tonë. Në krahasim tjetër, bashkitë e

Sarandës, Pustecit, Libohovës, Gjirokastrës, Dropullit, Kolonjës, Delvinës dhe Kamzës janë me nivelin më të ulët të prodhimit të perimeve në rang vendi.

Prodhimi i perimeve është i varur me së shumti nga përvoja dhe kushtet klimaterike të tokës. Myzeqeja, përveçse ka tokën e përshtatshme, ka edhe një përvojë të madhe për kultivimin

e perimeve dhe zhvillimin e bujqësisë në tërësi që para viteve 1990. Por rritjen më të madhe vjetore të prodhimit të perimeve pas Divjakës shihet ta ketë pasur bashkia e Fushë-Arrëzit, ku sasia e prodhuar është rritur me 33 për qind më 2019. Me tej në bashkinë e Mallakastrës prodhimi i perimeve është rritur me 33 për qind dhe gjithashtu në bashkitë e Kolonjës dhe Klosit prodhimi në ton u rrit me nga 31 për qind për secilën. Puka dhe Korça i rriten gjithashtu prodhimin me mbi 20 për qind. Ndërsa rënien me të mëdha të prodhimit më 2019 e patën bashkitë e Gjirokastrës me 23 për qind, Delvinës me 21 për qind, Libohovës me 17 për qind, Vlorës me 12 për qind dhe Përmetit me 10 për qind.

Komuna e Mitrovicës ofron mundësi për punë praktike me pagesë për studentët

MITROVICË, 7 JANAR (ER) - Komuna e Mitrovicës, respektivisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me organizatën "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin "Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë" projekt dyvjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti përfshin komunat: Mitrovicë e Jugut dhe Shtime. "Në kuadër

të aktiviteteve të projektit është planifikuar edhe përkrahja e studentëve me punë praktike si mundësi për punësim apo vetëpunësim. Përmes këtij aktiviteti do të organizohen pesë ditë trajnime profesionale dhe studentët do të sistemohen në punë praktike me pagesë në kompani, organizata apo institucione përkatëse të cilat ata do t'i kenë përcaktuar paraprakisht", ka njoftuar Komuna e Mitrovicës.

Kjo komunë ka ftuar studentët e drejtimit të bujqësisë dhe të

teknologjisë ushqimore të aplikojnë për angazhim në program të praktikës që përshtatet me profesionin e tyre. "Gjatë zbatimit dyvjeçar të projektit do të përkrahen gjithsej 20 studentë me punë praktike apo 10 studentë në vitin 2021 dhe 10 studentë në vitin 2022. Ky grup do të angazhohet në punë praktike në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme për një periudhë prej tre muajve me kompensim në baza mujore për t'i mbuluar shpenzimet e



udhëtimit, ushqimit dhe vjegëzën për aplikim e ka komunikimit", ka njoftuar publikuar në faqen zyrtare në Komuna e Mitrovicës, e cila "Facebook".

Komuna e Vushtrrisë fillon bërjen e testeve serologjike për Covid

VUSHTRRI, 7 JANAR (ER) - Komuna e Vushtrrisë ka filluar bërjen e testeve serologjike për Covid-19 për ta hulumtuar shkallën e përhapjes së këtij virusi. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ka bërë përgatitjet e duhura në këtë drejtim. "Do të fillojmë me punëtorët shëndetësorë, pastaj punëtorët e arsimit, Policinë e Kosovës në Vushtri dhe punëtorët e administratës. Testimi i qytetarëve do të bëhet vetëm me udhëzim të mjekut familjar. Testimi është falas. Testohen ata qytetarë të cilët nuk kanë



shenja klinike (qytetarët me shenja klinike testimin për Covid e kryejnë në IKShPK), pra nuk ka nevojë që qytetarët të shkojnë në

laborator, por fillimisht konsultohen me mjekun familjar i cili pastaj jep udhëzimin për testim", ka thënë Tahiri.

Shpërndahen pako ushqimore dhe higjienike për familjet në lagjen Brekoc të Gjakovës

GJAKOVË, 7 JANAR (ER) - Janë shpërndarë pako ushqimore, higjienike, batanije dhe jastëkë për familjet e dëmtuara nga vërshimet në lagjen Brekoc. Gjatë vizitës së tij te këto familje, nënkryetari i Komunës së Gjakovës, Flamur Fetahaj, e

ka falënderuar shoqatën "Bereqeti" për këtë ndihmë të vlefshme. Ndërkohë, ai është informuar nga banorët për problemin me vërshime në këtë anë, për të cilën çështje Komuna e Gjakovës do të gjejë zgjidhje të përhershme.




Doli nga shtypi libri i Faton Mehmetajt "Deçani nëpër shekuj"

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Ka dalë nga shtypi libri i radhës i autorit Faton Mehmetaj "Deçani nëpër shekuj". Ky libër është botuar nga Instituti për Studime Gjeopolitike dhe Siguri-Botime të veçanta "Hasan Prishtina". "Libri trajton historikun e Deçanit nëpër shekuj. Ka fakte e të dhëna që dalin për herë të parë dhe e demantojnë historiografinë serbe lidhur me disa përvetësime të vlerave tona kulturore dhe historike që i ka bërë Serbia dhe historianët serbë gjatë kohëve të ndryshme", ka bërë me dije autori i librit Faton Mehmetaj. Ai ka theksuar se libri "Deçani nëpër shekuj" paraqet me fakte të dhëna konkrete për promovimin e trashëgimisë sonë kulturore, historike, etnografike e arkeologjike ndër shekuj. "Ky libër është freskim



dhe ringjallje e kujtesës sonë kolektive për të kaluarën. Në këtë libër frymojnë natyrshëm historia, kultura, tradita, lashtësia, e djeshmja dhe e sotmja. Qëllimi i librit-biltenit 'Deçani nëpër shekuj' ka qenë të ilustrojë me materiale historiografike, fotografi e dokumente të tjera historikun e

Deçanit nga periudhat më të ndritura të historisë mijëvjeçare të popullit të trevës së Deçanit e deri në periudhën e luftës së lavdishme të UÇK-së. Me këtë rast dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata që kontribuuan për daljen në dritë të këtij libri", ka thënë autori i këtij libri, Faton Mehmetaj.



Më 25 prill tepsia mund të ngelë në të njëjtat duar?



Nga Bedri ISLAMI

Katër forca të reja politike si asnjëherë tjetër në një periudhë kaq të shkurtër, kanë zanafillën e tyre nga skizma me PD-në. Më shumë se me emrat e tyre, ata njihen si strukturat e Topallit, Patozit, Murrizit dhe Hajdarit dhe, që të katërta, në një mënyrë ose në një tjetër, janë shprehur për ndryshimin e këtij detashmenti politik, ku, që të gjithë, deri para katër vjetësh kanë qenë pjesë jo pak e rëndësishme.

Kundër kujt janë këto forca politike dhe kë mbështetin?

Janë vërtet risi politike, ku mund të besosh apo e vjetra rivjen, edhe kësaj here, përmes riciklimit të së vjetrës? Janë ngritur vetvetiu apo dikush tjetër qëndron pas tyre? Kanë ata veç e veç, apo të gjitha së bashku, atë vitalitet politik saqë t'i përmbysin fronet ku është ulur prej kaq viteve një klasë politike thellësisht e korruptuar dhe mizore, apo e gjitha është një lojë e vjetër me karta të reja?

Që të gjitha, megjithëse deklarohen se janë për përmbysjen e qeverisë Rama, në të njëjtën kohë janë edhe kundërshtarë të partisë së tyre mëmë, sidomos të liderit të saj, Basha. Për arsye që dihen, ata e kanë shpallur drejtimin e PD-së nga Basha si një dështim të turpshëm, amorf, pa asnjë ide

dhe shërbyese e qëndrimit në pushtet të Edi Ramës. Më shumë duket se do të shpallin luftë kundër Bashës sesa ndaj së majtës, që politikisht ka qenë kundërshtarja e tyre. Zemërimi i tyre ndaj partisë nga erdhën në politikë është i pareshtur dhe janë në të drejtën e tyre të dëshmojnë një të vërtetë që dihet: në ujërat që nuk lëvizin, gjërat marrin erë. Dhe Basha është një lider që lëviz me shumë vështirësi, më tepër është ngurrues sesa veprues, i paqëndrueshëm, por llogaritës i hollë. As Topalli e as Patozi nuk e kishin menduar se në vitin 2017 do të ishin jashtë listave dhe se rrugët e politikës, të paktën për katër vjet, do të ishin të mbyllura për to. Qetësia e Bashës, që është në gjithçka e kundërta e Berishës dhe harresa e qëllimshme e këtij të fundit ndaj figurave politike që i kishte pasur nënkryetarë, janë shenja e parë se lufta do të jetë brenda llojit dhe do të jetë e rëndë, e vazhdueshme dhe me pika të pakta bashkimi.

Murrizi dhe Hajdari, po ashtu, tehun më të madh e kanë ndaj Bashës, ku mendojnë se mund të marrin më shumë vota dhe kanë përparësinë e lëshimeve që u ka bërë Rama në parlament, pa e menduar se e ka bërë këtë kur u duheshin dhe se, edhe pak, nuk do t'i duheshin më, vetëm nëse bëjnë mrekulli më 25 prill dhe bëhen të domosdoshmit e qeverisjes, çka e vështirë të ndodhë.

Asnjëra nga forcat e katërshes nuk janë risi politike. Asnjë ide apo vizion i tyre, asnjë lëvizje politike nuk sjell risi, duke ia filluar që nga katarsisi i asaj që ka ndodhur kur kanë qenë pjesë

drejtuese e deri te qëndrimet e tashme.

Më shumë se luftë e ideve, do të jetë luftë e figurave. Çdo i larguar apo i lëçitur nga Basha do të gjejë vend në portat e reja që janë hapur. Secili që do të pranojë të trokasë do ta gjejë portën e hapur, por kjo nuk përbën as risi dhe as pastrim të politikës. Të gjithë janë të njohur, të gjithë të provuar.

Topalli dhe Patozi kanë qenë ndër mbështetësit kryesorë të çdo lëvizje në qeverinë Berisha, megjithëse nuk kanë qenë pjesë të kabinetit por, ama, funksionarë të rëndësishëm kanë qenë: e para si kryetare e parlamentit në tetë vjet e thuasje po aq edhe si nënkryetare, në qeverisjen e së majtës; i dyti nënkryetar i partisë dhe shef i grupit parlamentar. Asnjëri prej tyre nuk nxori zë kur ndodhi tragjedia e Gërdecit, kur u vranë njerëz në bulevard, kur zëvendëskryeministri i qeverisë së përbashkët me LSI-në shfaqej me bllok në duar duke kërkuar 700 mijë euro si paradhënie të një tenderi; nuk folën për drejtësinë kur vrasësit u shpërblen me disa rroga, kur u katapultua Basha dhe u eliminua më i guximshmi i tyre, Olldashi.

Pra, ata ishin pjesë e asaj që kishte ndodhur. Asnjëra prej tyre nuk ishte për "marshalla" e as "amen". Të gjitha ishin të turpshme.

Që nga dalja në skenë e "Bindjes Demokratike" u hodhën shumë dyshime: janë vërtet "të bindur", apo i kanë bërë të binden.

Që të jetë risi politike, kundër detashmentit politik të tashëm, një forcë e re politike, aq më tepër e dalë në një periudhë krize, qoftë

edhe të sajuar, si ajo e zgjedhjeve bashkiake, duhet të dëshmojë se është e pastër financiarisht. Pra, t'i dëshmojë burimet e saj financiare, ndryshe do t'i lërë rrugë mendimit që bulon edhe sot e kësaj dite se bindja, si forcë politike, më shumë është e bindur ndaj shefit të qeverisë sesa ndaj vizionit për ndryshim. Nëse nuk e ka bërë këtë, atëherë do të futë në një qark dyshues edhe forcën politike të Topallit që, po ashtu, gjen një çast të ngjashëm për ngritje: prag zgjedhjet politike!!!

A është ndasia e tyre me PD-në dhe me Bashën kaq e madhe saqë të krijojë vetvetiu këtë ndarje politike? Nëse do të ishin deputetë në vitin 2017 a do të kishim këtë ndarje dhe pse do ta kishim? Deri tani e vështirë për t'u marrë me mend dhe, edhe më tej, e vështirë për të qenë e besuar? Nga një shkak: ata janë ndarë me liderin, por jo me bëmat e forcës ku ishin numri dy e numri tre!!!

A mund ta përmbysin fronin e uzurpuar nga një klasë politike që në 30 vjet bëri pak hair e shumë dëm?

Ta lëmë mënjane se edhe këto, vetë ose prindërit e tyre - rasti Hajdari, ishin pjesë e kësaj klike dhe, duke përjashtuar zotin Murrizi, tek i cili njeriu mund të besojë, janë tani njerëz të pasur, me gjendje të fuqishme financiare, me shtëpi dhe pasuri të tjera. A janë aq të besuar sa "të nusërojnë" edhe një herë? E vështirë të mendohet e po aq e vështirë, në mos më shumë, të besohet!

Forca e tyre politike, veç e veç, është minore. Ata mund të përbëjnë një levë të

domosdoshme vetëm nëse bashkohen në një njësi të vetme, kur edhe numri i paktë i deputetëve mund të sjellin të domosdoshmit në qeverisje, rol të cilin e ka bërë deri para katër vjetëve LSI-ja. Vonesa e Bashës për të pasur një konfiguracion politik të hartës së deputetëve, aq më tepër ngurrimi për t'i caktuar drejtuesit politikë në disa qarqe, do të krijojë edhe më tej panik në një pesëshe tjetër rreth opozitës, disa drejtues të së cilës presin t'u bjerë nga qielli "buka e premtuar", sidomos Ndoka dhe Dule. Edhe të tjerët nuk janë të sigurt se ku do të jenë, në cilat lista, në cilin rend, apo do të jenë pas listës si në vitin 2017 kolegë të tyre!


Më shumë se gjithçka tjetër kjo është një lojë e vjetër e politikës me karta, po ashtu, të vjetra. Megjithatë, disa prej tyre e luajnë krejt mirë dhe asnjë rastësi nuk do të jetë e tillë.

Në kohën kur më shumë se 13 forca politike, që nga e majta e njohur dhe deri tek e djathta, që nga forcat e njohura si PD dhe LSI e deri te Lëvizja VV!, janë rreshtuar kundër Edi Ramës, nuk do të ishte çudi që ndërsa ata vazhdojnë të kapin në të njëjtin hulli, kreu i Rilindjes të vazhdojë të qeverisë.

13 copët e tepsisë së pushtetit mund të ngelin nëpër dhembë, ndërkohë që mund të ndodhë e pandodhura: tepsia të ngelë në të njëjtat duar dhe të tjerët të sillen rreth saj... enigmë është se cilët do të ftojë Edi Rama për t'i "ngrënë" anët e tepsisë: nga të vjetrit apo të rinjtë që nuk janë edhe aq të rinj.

Kartat po hidhen! Nuk dihet vetëm se kush i përziën!





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Bashkimi fiton derbin ndaj Pontes, Rahoveci triumfon në Mitrovicë



PRIZREN, 7 JANAR - Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Ponte Prizrenit 71:66 (13:17, 18:9, 25:17, 15:23) në kuadër të javës së 13-të të Prince Caffè Superligës së Kosovës në basketboll. Në çerekun e parë më e mirë ishte Ponte, duke fituar këtë pjesë 13:17. Por, në të dytën u kundërpërgjigjen portokallezënjtë, duke fituar 18:9, për të shkuar në pushim 31:26.

Bashkimi vazhdoi me lojë të mirë edhe në periudhën e tretë, që e fiton 25:17, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 56:43. Megjithatë, Ponte nuk u dorëzua dhe luftoi deri në fund. Basketbollistët e Prizrenit arritën ta afrojnë rezultatin në 68:66, por një trepikësh nga Qëndrim Biraj vendosi gjithçka dhe Bashkimi fitoi derbin e Prizrenit me shifrat 71:66. Te Bashkimi

u dalluan Endrit Hysenagolli me 15 pikë dhe 20 kërcime, Julian Hamati me 12 pikë e 18 kërcime dhe Sean Hoehn me 19 pikë, kurse te Ponte Prizreni u dalluan Arti Hajdari me 25 pikë, Xavier Cannefax me 19 pikë dhe 10 pikë e 10 kërcime. Bashkimi ka shtatë fitore dhe gjashtë humbje, kurse Ponte Prizreni nëntë fitore dhe katër humbje.

Në ndeshjen tjetër KB Rahoveci ka shënuar fitore ndaj Trepçës në udhëtim me rezultat 67:81 (14:26, 16:23, 23:14, 14:18). "Vreshtarët" e nisën ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 14:26, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, 16:23, duke shkuar në pushim me shifrat 30:49. Vendasit e nisën më mirë pjesën e dytë, përkatësisht periodën e tretë 23:14 megjithatë, në

10 minutat e fundit, rahovecasit fituan 14:18, për të triumfuar në fund 67:81. Te Trepça u dalluan Erving Robert me 25 pikë e gjashtë asistime dhe Staphon Javonnie me 11 pikë e 18 kërcime, kurse te Rahoveci u dalluan Isaiah Traylor me 25 pikë e gjashtë kërcime, Marvin Jones me 19 pikë e gjashtë kërcime dhe Alban Veseli me 17 pikë e gjashtë kërcime.

Trepça ka dy fitore dhe 11 humbje, kurse Rahoveci 10 fitore dhe tri humbje.

SUPERLIGA - Java 13

Trepça - Rahoveci	67:81
Bashkimi - Ponte Prizreni	71:66
Golden Eagle Ylli - Peja	89:73
Vëllaznimi - Sigal Prishtina	62:69

SHKURT

Trabzonspori interesohet për Berishën

Klubi i njohur turk Trabzonspor është duke u interesuar për transferimin e sulmuesit Mërgim Berisha, i cili është pjesë i Red Bull Salzburgut. Mediumet turke kanë raportuar të enjten se Trabzonspori ka kontaktuar ekipin austriak në lidhje me transferimin e Berishës gjatë afatit kalimtar të janarit. 22-vjeçari ka shpërthyer këtë edicion të Salzburgu, ekip me të cilin ka kontratë deri në verën e vitit 2022. Ai ka shënuar 12 gola dhe ka bërë katër asistime në 20 ndeshje të luajtura në të gjitha garat për ekipin austriak.

Gjoni largohet nga Llapi

KF Llapi ka njoftuar se pas marrëveshjes së arritur ndërmjet drejtuesve të klubit dhe qendërmbrojtësit Eglentin Gjoni, palët kanë ndërprerë bashkëpunimin, i cili ishte i vlefshëm edhe për pjesën e mbetur të këtij edicioni. "KF Llapi dhe Eglentin Gjoni e panë të arsyeshme dhe më korrekte ta përmbyllnin marrëveshjen para kohe. Drejtuesit e klubit çmojnë kontributin e tij për klubin gjatë periudhës gjashtëmujore sa ishte pjesë e KF Llapit si dhe i dëshirojnë shumë suksese në karrierë", thuhet në njoftimin e Llapit.

10 futbollistët më të shtrenjtë në botë, mungojnë Messi dhe CR7

Lista e lojtarëve më të shtrenjtë në botën e futbollit po ndryshon nga viti në vit dhe emra të rinj shfaqen herë pas here. Së fundmi, CIES ka publikuar një listë të përbërë me 10 lojtarët më të shtrenjtë në botë për momentin. Listën momentalisht e kryeson ylli i Manchester Unitedit, Marcus Rashford ku, sipas CIES, ai është lojtari më i shtrenjtë me një vlerë më shumë se 145 milionë paundë. Pas tij vjen lojtari më i mirë 20-vjeçar, Erling Haaland, që ka një çmim prej 137 milionë paundësh. Lista më pas përbëhet nga lojtarë të tjerë siç janë: Trent Alexander-Arnold, Bruno Fernandes, Kylian Mbappe, Jadon Sancho, Joao Felix, Alphonso Davies, Raheem Sterling dhe Kai Havertz. Pra, në këtë listë nuk ka vend për lojtarë të mëdhenj si Lionel Messi, Neymar e Cristiano Ronaldo.

Gjoni dhe Rapo përforcojnë Drenicën

Skenderaj, 7 janar - Skuadra e Drenicës ka prezantuar dy përforcimet e radhës në afatin kalimtar të janarit. Fjala është për qendërmbrojtësin, Eglantin Gjoni, i cili së fundmi ka qenë pjesë e Llapit dhe mesfushorin, Donald Rapo që ishte pjesë e Laçit në Shqipëri. "Në vazhden e konsolidimit të skuadrës për

stinorin pranveror 2021, drejtuesit e klubit kanë përmblytur edhe dy marrëveshje me dy futbollistë. Fjala është për qendërmbrojtësin, Eglantin Gjoni, i cili më herët ishte pjesë e Laçit kurse se fundmi u aktivizua në KF Llapi. Gjoni ka nënshkruar kontratë deri në fund të këtij kampionati me

mundësi vazhdimi. Ndërkohë, edhe mesfushori Donald Rapo, do të veshë fanellën kuq e zi, deri në fund të këtij kampionati. Rapo se fundmi u aktivizua të skuadra e Laçit në Shqipëri. Drejtuesit e klubit gjatë ditëve në vijim, do të prezantojnë edhe përforcime tjera", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi.



Japonia, për shkak të Covidit, ndalon shfaqjen e pishtarit olimpik

Torino, 7 janar - Japonia ka ndaluar shfaqjen publike të pishtarëve olimpikë dhe paraolimpikë pas një rritjeje të madhe të të infektuarve me koronavirus. Kryeministri Yoshihide Suga ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme për Tokion dhe zonat përreth. Tokio raportoi 2 447 raste të reja të

infeksionit të enjten, që është një rritje e madhe në vend. Për shkak të pandemisë, Lojërat Olimpikë në Tokio, të cilat supozohej të mbaheshin verën e kaluar, u shtynë për një vit dhe do të fillojnë më 23 korrik. Lojërat Paraolimpikë do të fillojnë më 24 gusht. Një deklaratë nga autoritetet e

Tokios thotë se vendet ku ishin ekspozuar pishtarët do të anulohen që nga sot dhe se do të jetë kështu të paktën deri më 29 janar. Gjendja e jashtëzakonshme në Tokio do të zgjasë të paktën deri në javën e parë të shkurtit, prandaj të gjitha manifestimet e planifikuara në lidhje me pishtarin olimpik do

të shtyhen. Stafeta e flakës olimpikë duhet të fillojë më 25 mars, me pjesëmarrjen e 10 000 vrapuesve. Në një sondazh të kryer muajin e kaluar nga televizioni kombëtar japonez NHK, nga 1 200 të anketuar, 63 % besojnë se Lojërat duhet të shtyhen ose të anulohen përsëri.



Presidenti i UEFA-s nuk e kundërshton ligën e përbashkët në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 7 JANAR - Kosova dhe Shqipëria nuk janë vendet e vetme në të cilat qe disa vite qarkullon ideja e krijimit të një lige të përbashkët të futbollit. Ideja për krijim të ligave rajonale qarkullon edhe në disa pjesë të tjera të Evropës në mes dy, tri apo edhe më shumë shtetesh fqinj. Dhe, këto ide tashmë janë shprehur edhe në UEFA. Presidenti i shtëpisë së futbollit evropian, Aleksandër Çeferin, në një intervistë të fundit ka konfirmuar interesimin e disa shteteve anëtare të UEFA-s për krijimin e ligave të tilla të përbashkëta. Dhe, Çeferin ka potencuar se UEFA nuk është kundër ideve të tilla. Por, thekson se duhet të shqyrtohen me kujdes këto ide në mënyrë që të merren vendime të mira dhe në interes të futbollit dhe të mos gabohet në hapa. "Ne në UEFA jemi duke menduar për ligat rajonale dhe kemi mund të konfirmoj se kemi biseduar me udhëheqës të federatave kombëtare, anëtare të UEFA-s,



për këto ide", ka deklaruar Çeferin. "Secilën herë e më shumë idetë e tilla dhe interesimi po rritet sepse ka përshtypje se ligat e tilla rrisin vlerën e klubeve, rrisin vlerën e tregjeve, pastaj të ardhurat nga sponsorët, shitjen e të drejtave televizive etj. Në parim, UEFA nuk ka asgjë kundër krijimit të ligave të tilla rajonale. Por, ekziston një problem se si të shkohet në gara evropiane nga ato liga. Pastaj, duhet të shqyrtohet me kujdes nëse ato liga i dëmtojnë kampionatet kombëtare. Pra, si ide

shqyrtohet, por konkrete nuk ka asgjë. UEFA duhet ta zgjedhë me kujdes këtë çështje", ka theksuar Çeferin. Kosova dhe Shqipëria qysh prej vjetësh e shqyrtojnë idenë e krijimit të një lige të përbashkët, e cila në Prishtinë e Tiranë qarkullon qysh prej para anëtarësimit të Kosovës në UEFA. Të dyja federatat gjithnjë kanë shprehur admirim për realizimin e kësaj ideje, por pa bërë hapa konkretë, duke konsideruar se diçka e tillë duhet të bëhet me kujdes dhe në koordinim me UEFA-n.

Pirlo: Pas disa muajsh do ta shihni Juven e vërtetë

TORINO, 7 JANAR - Një fitore që i jep qetësi Juventusit për vazhdimësinë. Suksesi në supersfidën ndaj Milanit ishte shumë i rëndësishëm për skuadrën e Andrea Pirllos me trajnerin e "bardhezinjëve" që në analizën që i bëri sfidës foli me superlativa edhe për disa elementë në veçanti. "Ishte e rëndësishme për ne. Nuk ishim të interesuar për rezultatet e ekipeve mbi ne në renditje, pasi ishim të përqendruar në progresin tonë. Do të shohim pas disa muajsh ku jemi. Gjëja e rëndësishme ishte kjo frymë e një ekipi që dëshiron të ketë lojën në kontroll, veçanërisht kundër kryesuesve të Serisë A në fushën e tyre. Ideja ishte ta mbanim nën presion dhe të mos e lejonim të shtynte përpara si zakonisht, veçanërisht kur kishte situata një kundër një", ka thënë Pirlo. "Rabiot po vinte nga dy ndeshje në tribunë, kështu që ai



ishte i freskët dhe i etur për të luajtur. Ai është një mesfushor që bën të dyja fazat e lojës dhe mendoj se as ai vetë nuk e kupton potencialin që ka. Bentancur ishte i lodhur dhe duke parë që ishte në rrezik të kartonit të dytë të verdhë, ne lëvizëm shpejt dhe e zëvendësuam atë. Të gjithë këtu mund të jenë zgjedhje e parë, por edhe zgjedhje e dytë. Unë jam me fat sa të jem në gjendje të zgjedh ndeshje pas ndeshje

bazuar në situatën e momentit dhe karakteristikat e kundërshtarëve tanë", ka deklaruar Pirlo. Në fund trajneri i "Zonjës së Vjetër" e komentoi edhe paraqitjen e Paulo Dybalas. "Kishim shumë nevojë ta kishim Dybalan në formën më të mirë pas problemeve të fundit. Ai ende ka disa probleme fizike dhe nuk ka qenë në më të mirën e tij gjatë gjithë sezonit. Kontrata e tij? Nuk është roli im të merrem me kontratat", ka deklaruar Pirlo.

SHKURT

Grezda, afër transferimit në Korenë e Jugut

Mesfushori kuqezi Eros Grezda do të ndryshojë përsëri ekip, madje edhe kampionat. Pasi u largua nga Rangers për t'u kthyer tek Osjeku, ka vendosur t'i japë fund aventurës në kampionatin kroat. Sipas asaj që raportohet në Kroaci, Grezda e ka mbyllur edhe përvojën e tij me Osijekun. Sulmuesi shqiptar nuk u ngjit në të njëjtën lartësi në rikthim me ekipin kroat, teksa kaloi edhe një dëmtim të gjatë. Dy pistat e mundshme e dërgojnë Grezden në Korenë e Jugut, atje ku pritet të përfitojë shumë në aspektin financiar. Gjithashtu, shfaqet edhe Holanda. Ende nuk janë zbuluar emrat konkretë të ekipeve, por gjithçka do të bëhet e qartë në ditët në vazhdim.

Alex Morgan dhe familja e saj infektohen me Covid

Alex Morgan ka zbuluar se ajo dhe familja e saj kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Futbollistja 31-vjeçare në "Twitter" ka njoftuar ndjekësit e saj se ajo, burri Servando Carraso dhe vajza e tyre shtatëmuajshe Charlie janë infektuar pasi u kthyen nga pushimet në shtëpinë e tyre. "Për fat të keq, unë dhe familja ime e kemi mbyllur vitin 2020 me Covid-19 sa ishim në Kaliforni gjatë pushimeve. Të gjithë jemi në gjendje të mirë shpirtërore dhe po rimëkëmbemi mirë", ka shkruar Morgan në "Twitter".

Tottenhami 'blindon' Sonin

Pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 dhe ndërprerjes për rinovim të kontratave me futbollistë, drejtuesit e klubit të Tottenham Hotspur kanë besim se ylli i skuadrës Heung-Min Son do ta rinovojë kontratën me "Spursat". Futbollisti i kombëtares së Koresë së Jugut, të cilit i skadon kontrata me klubin londinez në verën e 2023-s, do ta zgjasë kontratën duke përfituar 25 % rritje të pagës, që aktualisht kap shifrën e 150 mijë paundëve. Pavarësisht se financat e klubit janë prekur nga pandemia, administratori i klubit, Daniel Levy, ka prioritet rinovimin e kontratës së 28-vjeçarit.

Koeman: Do të luftojmë deri në fund për titull

Trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, ka këmbëngulur se skuadra e tij do të luftojë për titull në La Liga deri në ndeshjen e fundit, pas fitores kundër Athletic Club të mërkurën. Këto tri pikë nënkuptojnë se Barcelona tani ngrihet në pozitën e tretë, pas Atletico Madridit dhe Real Madridit. "Jam i lumtur me rezultatit ndaj Bilbaos dhe sesi e arritëm atë. Ne e merituar fitoren. Loja ekipore ishte fenomenale. Ne do të luftojmë deri në ndeshjen e fundit. Kemi ngelur pak mbrapa, por jemi në rrugë të mirë. Pedri po tregon maturi, ndërsa loja e Messit dhe demonstrimi i vullnetit të tij janë të qarta, por sot ai e tregoi këtë me gola", ka thënë Koeman.

Pogba: Është e vështirë për Unitedin

Paul Pogba ka paralajmëruar Manchester Unitedin se do ta vazhdojnë 'rënien' e tyre në qoftë se nuk fitojnë duelet e mëdha, njësoj sikurse ndeshja e fundit ndaj Manchester Cityt. "Djajtë e Kuq" janë eliminuar nga "Citizens" në Carabao Cup dhe si rezultat i kësaj, menaxheri Ole Gunnar Solskjaer ka humbur të gjitha gjysmëfinalet që ka marrë pjesë me Manchester Unitedin. Francezi ka treguar se është shumë e vështirë për të luajtur në këtë klub. "Është e vështirë dhe do të jetë kështu. Ju duhet të mësoni nga ndeshja në ndeshje. Do të na ndihmojë të shkojmë përpara dhe të bëhemi më mirë. As futbollit e as të luash për Man Unitedin nuk është e lehtë. Nuk do të jetë kurrë e lehtë, por pikërisht kjo e bën fitoren më të bukur kur kalojmë një kohë të vështirë", ka thënë Pogba.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

